

V E N D I M
Nr.83, datë 18.2.1999

**PËR RRITJEN E PAGESËS KALIMTARE TË USHTARAKËVE TË NXJERRË NË
REZERVË (LIRIM)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 5, nenit 10 shkronja b, dhe nenit 18 të ligjit nr.8087 datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror, suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pagesa kalimtare, që përfiton ushtaraku në bazë të ligjit nr.8087 datë 13.3.1996 neni 10 shkronja b, të rritet 10%.
 2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 1999, për ministrinë përkatëse.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 1999.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko